



Crna Gora / Mali i Zi  
OPŠTINA ULCINJ  
KOMUNA E ULQINIT  
Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj  
Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik  
Br. / Nr. 08-082/24-1291/1  
Ulcinj / Ulqin, 08.10.2024. god.vit

**PROGRAMI I SHQYRTIMIT PUBLIK  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR TRANSPORT ME  
AUTO-TAKSI NË TERRITORIN E KOMUNËS SË ULQINIT**

Kryetari i Komunës së Ulqinit, me vendimin numër 01-040/24-1384/1 të datës 26.09.2024, ka konfirmuar Projekt Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për transport me autotaksi në territorin e komunës së Ulqinit si dhe përcaktoi që shqyrtimi publik për projektvendimin e lartëpërmendur të zgjasë 15 ditë duke obliguar Sekretariatën për ekonomi dhe zhvillim ekonomik të realizojë shqyrtimin publik.

Shqyrtimi publik në lidhje me Projekt Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për transport me auto-taksi në territorin e komunës së Ulqinit në kohëzgjatje prej 15 ditëve do të zgjasë prej datës 09.10.2024 deri më 24.10.2024.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe mendimet në formë të shkruar duhet të dorëzohen në adresën Komuna e Ulqinit – Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik përmes Zyrës së qytetarëve të Komunës së Ulqinit ose në formë elektronike në emailin [ekonomi@ul-gov.me](mailto:ekonomi@ul-gov.me) brenda afatit të përcaktuar.

Qasja në projekt Vendimin gjatë periudhës së shqyrtimit publik mund të realizohet në ambjentet e Sekretariatit për ekonomi dhe zhvillim ekonomik të Komunës së Ulqinit (Adresa: Bul. Gj. K. Skënderbeu) në zyrën numër 124 të hënën, të mërkurën dhe të premten nga ora 11:00 deri në 13:00.

Projekt Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për transport me autotaksi në territorin e komunës së Ulqinit do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Ulqinit [www.ul-gov.me](http://www.ul-gov.me).

Shqyrtimi publik qendror do të mbahet në sallën e vogël të Kuvendit të Komunës së Ulqinit me datë 22.10.2024, me fillim në ora 11:00.

Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik do t'i shqyrtojë të gjitha vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe mendimet e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik, pas të cilit do të hartojë raportin e shqyrtimit publik.

**SEKRETARIATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM EKONOMIK**

